

Në kohë si këto, cooperation-bashkepunim-saradnja-suradnja-сoрaбoткa-сapaдњa ka edhe më shumë rëndësi

Op-Ed nga Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Majlinda Bregu & Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme, Tanja Miscevic

Është e pazakontë që një Op-Ed të nënshkruhet nga dy persona. Me përjashtim të ndonjë çështjeje me rëndësi të lartë. Ne nuk jemi të gjithë njësoj. Ky është në fakt edhe aseti më i çmuar i RCC-së. Ne vijmë nga vende të ndryshme, fe e prejardhje të ndryshme. Kemi këndvështrime të ndryshme për problemet dhe të gjithë sjellim një perspektivë të caktuar identiteti që pasuron hapat e përditshëm për bashkëpunim rajonal. Në një rajon kompleks, bashkëpunimi është thelbësor nëse ka përparime që duhen bërë. Me fjalë të tjera, flamuri që ne ngremë është Bashkimi.

Është Tetor 2020. Të gjithë e kemi jetuar jetën përgjatë këtyre muajve në korsinë e ngadaltë.

Gjashtë muaj më parë të gjithë mund të kemi menduar se pandemia e COVID 19 do të merrte fund me ikjen e verës e se ne do t'i ktheheshim zakoneve tona të përhershme të jetesës. Sot, teksha shkruajmë këtë material, duke punuar nga shtëpitë tona njëra në Tiranë dhe tjetra në Beograd, është e qartë se mënyrat e zakonshme të jetesës kanë ndryshuar, na kanë ndryshuar edhe neve, në mënyrë drastike madje.

Vendosja e maskës, distancimi fizik, shmangia e përqaftimeve miqësore edhe me ata që kemi kohë pa takuar, puna, takimet dhe mbledhjet e punës si dhe mësimi online... janë normaliteti ynë i ri tashmë dhe nuk mund të mos ndiejmë nostalgji për të gjitha gjërat që i morëm të mirëqena më herët. Dhe ndërkohë që presim zgjidhjen shkencore ndaj këtij armiku me madhësi mikroskopike, por fatale, ne po punojmë dhe po bëjnë luftën tonë për të mbajtur gjallë besimin, si dhe për të gjetur mundësinë për t'i bërë gjërat të funksionojnë më mirë – ky është momenti, e kemi kuptuar se sa relative dhe e pasigurt është gjithçka.

Pasojat e këtij armiku të vogël e të përbashkët po ngrenë kryet e tyre të shëmtuara. Është e dukshme në të gjithë botën. Në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor, edhe më shumë, pasi si ekonomikisht ashtu edhe në aspektin social, kemi hyrë në pandemi me disavantazhe të mëdha krahasuar me fqinjët tanë të BE-së. Si fillim shëndeti, vija e parë e luftës kundër virusit është një shembull i mirë, pasi investimet e Ballkanit Perëndimor në këtë sektor para pandemisë ishin shumë modeste - duke filluar nga 2.9% në maksimumin 5.4% të PBB (krahasuar me 7% të mesatares së BE-së, duke mos harruar që në mënyrë kumulative flasim për shumë më shumë para pasi PBB-të në BE dhe në rajon nuk krahasohen). Pra, kjo neglizhencë tradicionale në sektorin shëndetësor, megjithë përpjekjet e shumta për t'u reformuar, na la me vetëm 2.3 mjekë për 1000 banorë (mesatarja e BE: 3.7), 5 infermierë (BE: 8.6) dhe më pak se 4 shtretër (BE: 6.1) – kjo çoi edhe në “Listën e zezë” kategoria e numrit të qytetarëve të infektuar për 100,000 banorë. Kombinuar me investimet po aq modeste në fushën kërkimore, si dhe ato të fundit për gjetjen e kurës (rreth 1% e PBB-së është mesatarja e Ballkanit Perëndimor), ndikimi në aspektin social ishte i garantuar - ankth për atë që do të ndodhte.

Edhe impakti ekonomik nuk ishte surprizë. Mjafton të shkosh në qendrën më të afërt tregtare e të numërosh sa dyqane janë mbyllur. Ky është vetëm një gur i dominosë në gjithë efektin e shkaktuar – duke ulur vendet e punës dhe rritur papunësinë në rajon me 15% nga marsi në korrik të këtij viti.

Sidomos e goditur është rinia, papunësia e së cilës u rrit me 27%, duke e çuar numrin e të rinjve të papunë në pothuajse 800,000, ndërsa papunësia e grave arriti në 53%.

A jemi tashmë në recesion?

Disa vlerësime ekspertësh thonë se Ballkani Perëndimor do të përjetojë recesionin më të keq të dy dekadave të fundit. Dhe duket sikur tashmë ka filluar. Kapaciteti i dobët i kujdesit shëndetësor, mbështetja e madhe në rrjedhjen e kapitalit dhe në disa raste varësia e madhe nga turizmi do të përkeqësojë shkallën dhe kohëzgjatjen e rënies sonë ekonomike.

Rritja rajonale parashikohet të bjerë në -5.1%. Rënia e PBB-së në tremujorin e dytë të këtij viti është goditëse, në disa raste deri në -20%, kryesisht për shkak të kolapsit në turizëm (Tabela 1). Siç edhe çdo re ka një fije drite, ka edhe disa lajme të mira - rritja në rajon pritet të rimëkëmbet në 3.4% në 2021-shin. Investimet e Jashtme për vitin 2020 kanë rënë tashmë me 40%. Mbajtja e kompanive në këmbë duke stimuluar investimet në industri që lidhen me COVID-19 dhe mbajtja gjallë e zinxhirëve të furnizimit duhet të jetë një përparësi. Defiçiti i llogarisë rrjedhëse të rajonit është 6% të PBB-së, niveli më i lartë në 5 vitet e fundit, duke sugjeruar që pozicionet e jashtme në shumë ekonomi të vendeve të rajonit të jenë vulnerable.

	Q1 2020 (%) Stat. Offices	Q2 2020 (%) Stat. Offices
Ballkani Perëndimor		
AL	-2.3*	-10.2*
BiH	0.6	-10.5
KOS*	1.3	-9.3
MNE	2.7	-20.2
NM	0.2*	-12.7*
SRB	5.1	-9.2

Tabela 1: Ballkani Perëndimor Statistikat e Zyrës

*Q1 (Tremujori i parë i vitit 2020) Q2 (Tremujori i dytë i vitit 2020)

Dëmi i COVID-19 në turizëm

Gjashtë ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor raportuan 75% ulje të turistëve ndërkombëtarë në gjysmën e parë të vitit 2020 krahasuar me 2019-ën dhe një kthim në nivelet e rritjes para-COVID 2019 pritet të vijë pas 3 ose 4 vitesh. Niveli i pushimeve nga puna është mesatarisht 15-20% për punonjësit me kohë të plotë dhe 30-40% për punonjësit me kohë të pjesshme. Për ta bërë më konkrete këtë, disa shifra dëshmojnë për madhësinë e këtyre humbjeve: më shumë se 12 milionë njerëz vizituan rajonin vitin e kaluar, gjë që na solli një fitim prej 7.2 miliardë euro! Turizmi përbën 10.2% të PBB-së së rajonit dhe përbën më shumë se 25% të eksporteve! Mesatarisht, 11.4% e totalit të të punësuarve në Ballkanin Perëndimor vijnë nga ky sektor.

Të fillojmë të rimarrim veten tani

Duke pasur parasysh dobësitë më të mëdha dhe sektorët e dëmtuar, është e qartë se do të na duhet një dorë ndihme si dhe kombinim i forcave tona për të kapërcyer këtë sfidë të vështirë. Edhe një herë, Bashkimi Evropian (BE), partneri i besueshëm i rajonit, ka ndërhyrë me 9 miliardë euro të parashikuara në Planin e tyre të Investimeve Ekonomike (EIP) të Komisionit Evropian të prezantuar në fillim të kësaj jave, i cili erdhi në kohën e duhur. Së bashku me 3.3 miliardë euro të deklaruara tashmë për të luftuar shpërthimin e pandemisë, janë një shtysë për të ecur më shpejt drejt zhvillimit ekonomik, por gjithashtu edhe një herë rikonfirmon mbështetjen e pamohueshme për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Ky investim i BE-së, i mbështetur nga Western Balkans Guarantee Facility (Garantimi i Lehtësirave në Ballkanin Perëndimor), ka potencial për të tërhequr 20 miliardë euro më shumë nga investimet publike dhe private. Nëse i mbledhni këto shuma shkojnë në 32.3 miliardë Euro që vijnë drejt rajonit - një stimul i konsiderueshëm - pothuajse 30% e 100 miliardë Eurove të PBB të Ballkanit Perëndimor.

Plani është shumë specifik: investim në transport të qëndrueshëm (në rrugë dhe rrjet hekurudhor, lidhja e kryeqyteteve të rajonit), energjia e rinovueshme, klima dhe mjedisi, e ardhmja dixhitale dhe kapitali njerëzor, por gjithashtu rritja e sektorit privat dhe investimeve. I fundit, por jo më pak i rëndësishmi, nevojitet një Treg i Përbashkët Ekonomik Rajonal, i cili do të kapërcejë hendekun e konvergjençës ekonomike midis ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

Bashkëpunimi rajonal është një mjet për shërim më të shpejtë

Mënyra për të dalë nga kjo është ta bëjmë të gjithë së bashku - përmes veprimeve të përbashkëta për qëllime të përbashkëta. Kjo është zona e komfortit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në këto kushte të paretshme krijuar nga pandemia. Kemi gjetur zgjidhje të qëndrueshme, të bëra si me porosi për të përshtatur aspiratat dhe aftësitë e rajonit me realitetin e ri. Tregu i Përbashkët Rajonal – në axhendë për periudhën 2021-2024, për të cilin RCC me partnerët dhe qeveritë e Ballkanit Perëndimor ka punuar pa u lodhur për muajt e fundit, bazohet në qasjen “Four Freedoms” (Katër Liritë), duke pasqyruar ngushtësisht parimet dhe rregullat e Tregut të Përbashkët të BE-së. Sipas një studimi të Bankës Botërore, një integrim i tillë i zgjeruar i tregut të Ballkanit Perëndimor mund të sjellë një rritje shtesë prej 6.7% të PBB-së në rajon.

Kjo agjendë ambicioze përbëhet nga veprime të përcaktuara në katër fusha kryesore. Së pari, lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve, përfshirë masat ndërsektoriale, të tilla si Korridoret e Gjelbra, të lidhura me rregullat dhe standardet në përputhje me BE-në dhe për të siguruar mundësi për kompanitë dhe qytetarët.

Për më tepër, ekziston zona rajonale e investimeve për të harmonizuar politikat e investimeve me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe për të promovuar rajonin tek investitorët e huaj dhe brenda-rajonale. Këtu shohim një potencial të madh - më shumë investime që do vijnë në rajon do ta shndërrojnë rajonin në shumë më miqësor për investitorët, dhe në të njëjtën kohë do adresohen pikat më të dobëta të rajonit: papunësia dhe 'ikja e trurit'.

Së treti, zhvillimi i zonës dixhitale rajonale për të integruar Ballkanin Perëndimor në tregun dixhital pan-Evropian dhe së fundmi zhvillimin e një zone rajonale industriale dhe inovatore për të transformuar sektorët industrialë, për të formuar zinxhirët e prodhimit dhe për t'u përgatitur për realitetin e sotëm dhe sfidat e së nesërme.

Axhenda Jeshile e fundit, por jo më pak e rëndësishme; të gjitha aktivitetet do të kenë qasje të gjelbër, duke pasqyruar Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe duke e përkthyer atë në Axhendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor.

Fati ynë është në duart tona

Pra, ne po hedhim bazat – Investimet e Huaja dhe Tregu i Përbashkët Rajonal 2021-2024 përbëjnë një element të rëndësishëm të një rigjenerimi afatgjatë të Ballkanit Perëndimor. Kjo siguron një potencial të madh për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe transformim të plotë socio-ekonomik të rajonit. Thënë konkretisht: rrugë dhe hekurudha më të mira, punë më shumë dhe më të mira, konkurrencë e shëndetshme, ajër më i pastër, lumenj... Në kohë të tilla cooperation/ bashkëpunimi / saradnja / suradnja / саработка / сарадња merr edhe më shumë rëndësi. (thënë në gjuhët e Ballkanit Perëndimor).

Por, si në çdo gjë tjetër, e gjitha varet nga faktori njerëzor - gatishmëria për të bërë ndryshimin. Ne e vëmë në provë veten çdo ditë. Klubi ynë i Rcc-së nuk do të vlejë asnjë kacidhe nëse nuk veprojmë si një e tërë.

Dhe e tëra është gjithçka tjetër përveç, shumë më së të gjitha pjesëve – ka thënë dikush.